



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Jashtme / Ministarstvo Inostranih Poslova / Ministry of Foreign Affairs

Njoftim për shtyp!

Siera Leone njih Republikën e e Kosovës, shtet të pavarur dhe sovran

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar e Republikës së Siera Leones, përmes një note verbale ka njoftuar Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, se Republika e Siera Leones e ka njohur Republikën e Kosovës shtet të pavarur dhe sovran.

Në notën verbale të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar të Republikës së Siera Leones, thuhet se, Qeveria e Siera Leones e mirëpret Republikën e Kosovës në bashkësinë e kombeve. Në po të njëjtën notë verbale, mes të tjerash thuhet se, Qeveria e Siera Leones në veçanti, ka vërejtur garancitë se Republika e Kosovës do të jetë një shtet demokratik dhe multietnik, i cili do të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe trashëgimisë kulturore.

Siera Leone është vendi i 43-të që e njeh zyrtarisht Kosovën, shtet të pavarur dhe sovran.

Albana Beqiri

Këshilltare për medie e ministrit Hyseni